



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

DOKUMENTI I RREGULLORES SË VEÇANTË

“PËR MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:

NDËRTESË POLIFUNKSIONALE NË SHËRBIM TË KISHËS AUTOQEFALE ORTHODHOKSE E SHQIPËRISË, 2, 5 DHE 10 KATE MBI TOKË ME 1 KAT NËN TOKË ME VENDNDODHJE NË BASHKINË TIRANË.”



MINISTËR I INFRASTRUKTURES DHE ENERGIJSE

Znj. Behnida Balluku



Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit Nr. 11, Datë 18.04.2025

Projektues:

Varka arkitekturë



Zhvillues:

Kisha Autoqefale Orthodhokse e Shqipërisë



TABELA E PËRMBAJTJES SË DOKUMENTIT TË RREGULLORES SË VEÇANTË

1. Dispozita të Përgjithshme
 - 1.1 Baza Ligjore
 - 1.2 Përshkrim i zonës së studiuar
2. Ekstrakte të Planit të Përgjithshëm Vendor
 - 2.1 Përputhshmëria me kategorinë e përdorimit të tokës sipas PPV-së
 - 2.2 Seti i fragmenteve të hartave të PPV për zonën në zhvillim
3. Analiza e Gjëndjes Ekzistuese
4. Rregullat e Zhvillimit të Territorit
 - 4.1 Funksionet dhe aktivitetet e propozuara
 - 4.2 Pamja e Jashtme e Godinave / Trajtimi i Fasadave / Rifiniturave
 - 4.3 Përcaktimin e treguesve për zhvillim të projekt-propozimit
 - 4.4 Hapësirat e lira dhe të gjelbërta / vendparkimet
5. Rregullat e Rrjeteve të Infrastrukturës
 - 5.1 Pozicionimin e shërbimeve dhe rrjeteve kryesore të infrastrukturave



1. Dispozita të përgjithshme

1.1. Baza Ligjore

Kjo rregullore e veçantë përcakton kushtet e përgjithshme të Lejes së Ndërtimit për objektin: "Ndërtese polifunksionale në shërbim të Kishës Autoqefale Orthodhokse e Shqipërisë, 2, 5 dhe 10 katë mbi tokë me 1 kat nën tokë me vendndodhje në Bashkinë Tiranë ", me zhvillues Kisha Autoqefale Orthodhokse e Shqipërisë, bazuar në:

- Ligjin Nr. 107/2014, date 31.07.2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar nen 7 dhe nen 28.
- Vendimin nr 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave 'Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.
- Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tiranë (i ndryshuar), miratuar me vendim nr. 1 datë, 14.04.2017 të Këshillit Kombëtar të Territorit.

1.2. Përshkrim i zonës së studiuar

Trualli i ndërtesës është pjesë e ansamblit Orthodhoks pranë Rr. Kavajës me një sipërfaqe prej 1201 m². Ndërtesa e re do te fqinjësohet në veri me ndërtesën e Kishës Orthodhokse "Ungjillizimi", në perëndim me një ndërtesë banimi 10 k, ndërsa në lindje dhe jug me ndërtesat e ulëta të banimit të zonës përkatëse, subjekte zhvillimi në një të ardhme. Aksesi ekzistues bëhet nëpërmjet Rr. Kavajës.




Figura 1. Pozicionimi i truallit ne lidhje me qytetin



2. Ekstrakte të Planit të Përgjithshëm Vendor

2.1. Përputhshmëria me kategorinë e përdorimit të tokës sipas PPV-së

Duke u bazuar në rregulloren e Planit te Pergjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë, të miratuar pranë Këshillit Kombëtar të Territorit, me nr. 1 fatë, 14.04.2017 "Për miratimin e planit të përgjithshëm vendor Bashkia Tiranë", janë vlerësuar dhe respektuar të gjitha kategoritë e përdorimit të tokës që propozon plani si dhe parametrat e zhvillimit të saj.




Figura 2. Harta e përdorimit të tokës dhe harta e njësive strukturore

2.2. Seti i fragmenteve të hartave të PPV për zonën në zhvillim

Më poshtë paraqiten të gjitha-hartat nga plani i përgjithshëm vendor i Bashkisë Tiranë, në të cilat mendohet se propozimi i projektit, prezantuar në dosierin e projektit bashkëlidhur, do të jetë funksional dhe në përputhje të plotë me të gjitha kërkosat e zhvillimit të zonës në të ardhmen.






Figura 3. Harta e vizionit strategjik




Figura 4. Harta e rrjetit rrugor të propozuar

3. Analiza e Gjendjes Ekzistuese

Trualli ndodhet në afersi të Rrugës së Kavajës dhe më tej, Kishës Orthodhokse Ungjillizimi, shkollës të ciklit të ulët të Kishës dhe ambienteve të saj sportive, gjithashtu dhe objekteve të banimit në afersi. Për momentin sheshi përbën Kishës shërben si parkim për makina. Gjithashtu vihet re prania e gjelbërimit sic janë pemët e qiparisave që janë një pike e rëendësishme e projektit tonë. Duke patur parasysh praninë e shkollës së ciklit të ulët, ambientit sportiv dhe konceptit të ndërteses së re, trualli në fjalë ka të gjitha potencialet per t'u zhvilluar si një ansambël, një vlerë qe i shtohet Kishës por edhe zonës.



Figura 5. Pamje e gjendjes ekzistuese






Figura 6. Pamje e gjendjes ekzistuese



4. Ekstrakte të Planit të Përgjithshëm Vendor

4.1. Funksionet dhe aktivitetet e propozuara

Objekti zhvillohet në një pronë prej 1201 m^2 , dhe zë një sipërfaqe prej 411 m^2 në shesh. Objekti përbëhet nga 10 kate mbi tokë të shkallëzuara në 2, 5 dhe 10 me funksion polifunksional akademiko-administrativ kurse kati nëntoke ka funksion laboratoresh dhe biblioteke. Ndërtesa ka një sipërfaqje ndërtimore mbi tokë 4075.2 m^2 dhe nëntoke 1040 m^2 . Ndërtesa e re polifunksionale kërkon të plotesojë nevojat administrative dhe edukativo-arsimore brenda ansamblit orthodhoks në rrugën e Kavajës. Kjo ndërtesë nuk mund të funksionoje në mënyrë të pavarur nga ndërtesat dhe funksionet ekzistuese në këtë ansambël. Ajo do të plotesojë në mënyrë komplementare nevojat për zyra të reja administrative, do t'i bashkëlidhi programit edukativo-arsimor të ciklit të ulët edhe hapësirat e nevojshme për një cikël të mesëm në vazhdimësi. Kjo ndërtese do të japi dhe mari duke shfrytezuar hapësirat e ndërsjellta me shkollën e ciklit te ulët. Auditoriumi, laboratorët, biblioteka, zyrat, hollet dhe dhoma muzeale do të funksionojnë si elemente të të njëjtë trup. Sigurisht që këto dy ndërtesa do të shërbehen edhe nga palestra e myllur e cila është planifikuar të zhvillohet në vijim në hapësiren ekzistuese sportive. Ansamlli i ri orthodhoks kryqëzon në një kompozim mjaft interesant programe socialo – kulturore për mendjen, shpirtin dhe trupin, duke qenë shumë miqësor dhe i hapur për të rinjtë.




Figura 7. Koncept, ansamlli orthodhoks

PLANIMETRI KATI - 1
LABORATORIET DHE BIBLIOTEKA




Figura 8. Planimetri kati -1



PLANIMETRI E KATIT PERDHE

AKSES I DEDI KUAR




Figura 9. Planimetri kati 0






Figura 10. Planimetri kati +5



Në prerjen gjatësore të treguar më poshtë vlen për tu theksuar hapësira shumë ftuese e hollit të jashtëm për pritjen e nxënësve , gjithashtu dhe lartësia 4.55 m e hollit të brendshëm nga ku më pas nxënësit levizin për një klasat apo laboratoret perkates. Të gjitha hapësirat e tjera si akademike ashtu edhe administrative kanë një lartësi katër 391 cm . Kjo lartësi mundëson pajisjen e ndërtuesës polifunksionale me tavane teknike për ngrohje ftohje dhe ndricim specifik dhe për të pasur një lartësi standarde për programin në fjalë .




Figura 11. Prerje A-A

4.2. Pamja e jashtme e godinës/ Trajtimi i fasadave/ Rifiniturave




Figura 12. Koncept pamje e objektit te ri, nga hyrja, Rr. Kavajes



Ndërtesa e re në ansamblin orthodhoks plotëson kompozimin volumetrik duke mbyllur në një mënyrë të kuruar dhe të spikatur pamjen nga hyrja në rrugën e Kavajës. Kjo ndërtesë e re do të krijojë një sfond të ri urban për Katedralen e Evangjelizmoit. Neutraliteti ekspresiv, rregullsia arkitektonike dhe proporcionet e studiuara mirë do të kornizojne dhe do të evidentojnë më së miri arkitekturën e bukur te kishës. Projekti i i ndertesës së re tregohet i matur duke mos u përpjekur të dominojë ansamblin në formë, por të komplementojë të gjitha vlerat arkitekturore ekzistuese në të. Racionaliteti dhe modulariteti i ndërtesës do të mundesojë një ndërtim shumë cilësor për komunitetin orthodhoks dhe jo vetëm. Në të njëjtën kohë modulariteti krijon fleksibilitetin e "mbushjes" së hapësirave të brendeshme me një larmi programesh dhe funksionesh të ndryshme në kohë. Ndërtesa e re do të jetë një shenjë e re arkitekturore jo vetëm brenda ansamblit orthodhoks, por edhe një gjest urban respekti dhe rregullsie përfqinjët në këtë pjesë të qytetit.




Figura 13. Koncept pamje e objektit te ri,



Ndërtesa e re është konceptuar si një volum i shkallëzuar në mënyrë që të mundesojë dritëzimin e shtesit para kishës e në të njëjtën kohë të krijojë një prezencë miqësore. Në tarracën që krijuhet nga shkallëzimi mbi katin e dytë do të rimbillen 12 qiparisët ekzistues duke rikrijuar një sfond mjaft interesant të gjelbër për katedralen e në të njëjtën kohë do të krijuhet tarraca e 12 qiparisëve, si një hapësirë clodhëse dhe meditative. "Palosja" e katit te dytë krijon rezonancë formale dhe familjaritet me elementet arkitekturore të kishës në një mënyrë bashkëkohore. Kjo-palosje-formale kthehet në një seri elementesh arkitektonikë funksionale në fasadat anësore në formën e "perdeve" vizuale për të ndërmjetësuar vizualitetin e hapësirave të brendshme nga ndërtesa fqinje që ndodhen relativisht afër.




Figura 14. Pamje perëndimore






Figura 15. Pamje veriore



Figura 16. Imazhe të projektit

Në këto pamje shquhet qartë bashkëjetesa harmonike e ndertesës së re me ndërtesen e kishës, gjë e cila ka qenë e menduar që në fillesat e konceptit.

Kjo ndërtese e re është konceptuar si një volum i shkallëzuar në mënyrë që të mundesojë dritëzimin e sheshit para kishës dhe në të njëjtën kohe të krijojë një prezencë miqësore .





Figura 17. Imazhe të projektit



Këtu në këtë pamje vihet re më mirë tarraca që krijohet nga shkallëzimi mbi katin e dytë ku do të bëmillon 12 qipariset ekzistues duke rikrijuar një sfond mjaft interesant të gjelbër për katedralen dhe në të njëjtën kohë do te krijohet tarraca e 12 qiparisëve, si një hapësirë clodhëse dhe meditative. “Palosja” e katit të dytë krijon rezonance formale dhe familjaritet me elementët arkitekturorë të kishës në një mënyrë bashkëkohore.

4.3. Percaktimi i tregueseve per zhvilimin e projekt propozimit

Sipërfaqe e përgjithshme e truallit:	1201 m ²
Sipërfaqe e truallit e zënë nga struktura (gjurma):	411 m ²
Sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit mbi tokë:	4075.2 m ²
Sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit mbi dhe nën tokë:	5115.2 m ²
Koefiqenti i shfrytëzimit të truallit për ndërtim:	34 %
Koefiqenti i shfrytëzimit të truallit për rrugë dhe hapsira publike:	66 %
Intensiteti i ndërtimit:	3.39
Lartësia maksimale e strukturës nga niveli i kuotës së sistemimit:	40.44 m
Numri i kateve mbi tokë:	2, 5, 10 kat
Numri i kateve nën tokë:	1 kat

SIPËRFAQE PËR OBJEKTIN:

Sipërfaqe katni 0	411 m ²
Sipërfaqe katni +1	490 m ²
Sipërfaqe katni +2	490 m ²
Sipërfaqe katni +3	413.6 m ²
Sipërfaqe katni +4	413.6 m ²
Sipërfaqe katni +5	371.4 m ²
Sipërfaqe katni +6	371.4 m ²
Sipërfaqe katni +7	371.4 m ²
Sipërfaqe katni +8	371.4 m ²
Sipërfaqe katni +9	371.4 m ²

TOTALI I OBJEKTIT: 4075.2 m²

4.4. Hapesirat e lira dhe te gjelberta/ vendparkimet



Figura 18. Imazh, pamje veriore, sheshi para kishës

Kati i dytë i objektit del konsol mbi hyrjen kryesore duke krijuar një strehëzim dhe një ndjesi shumë ftuese për përdoruesit e tij. Ky shesh përpara ndërteses kthehet në një hapesirë të shtuar pa pengesa dhe bariera fizike ku mund të qëndrohet dhe gjatë festimeve të kalendarit orthodhoks. Mbi katin e dytë janë rimbjellë pemët e qiparisit, pjesë tashmë e historisë së këtij vendi duke krijuar një verandë të mrekullueshme dhe një sfond shumë të përshtatshëm për kishën. Gjelbërimi i mesëm dhe i ulët vijon të jetë i pranishem rreth objektit në vazoz të pershtatura për sistemimin. Përsa i përket parkimit ai mendohet të sistemohet në katin nëntokë të objektit ekzistues të ambientit sportiv.

5.0. Rregullat e Rrjeteve te Infrastruktures

5.1. Pozicionimi i sherbimeve dhe rrjeteve kryesore te infrastruktures

Aksesi kryesor në pronë do të bëhet nëpërmjet Rrugës së Kavajës, një aks kryesor në qytet, gjithashtu dhe ne zonë, e cila ndodhet në linjën veriore të objektit. Për shkak të vendndodhjes së truallit ai është momenti i vetem nga i cili mund të aksesohet prona. Parkimi është menduar të sistemohet në objektin ekzistues të ambientit sportiv.



Zhvillues:
Kisha Autoqefale Orthodhokse e Shqipërisë



Arkitekt:
Varka arkitekturë

